

---

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

**Raporti i Auditimit per Raportet e Financimit te  
Fushatës Zgjedhore 25 Prill 2021**

---

**Partia Kristian Demokrate, PKD**

## **I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **A. INFORMACIONI LIGJOR**

#### **i. Kuadri ligjor**

- Ligji nr. 10091, date 5.03.2009 "Per auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" i ndryshuar
- Standartet Nderkombetare te Auditimit
- Ligji nr. 10019 date 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise. i ndryshuar.
- Ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar
- Aktet nenligjore te KQZ
- Vendim Nr. 426, datë 12.07.2021 "Për shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve financiare dhe audituesve ligjore të cilet do te kryejne auditimin e fondeve dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore.

#### **ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme**

- Ligji Nr.25/2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

### **B. OBJEKTI I AUDITIMIT**

- Kontrata e shërbimit nr. 6583 prot. Date 28.09.2021, me objekt "Kryerja e auditimit te detyrueshem te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet e dates 25.04.2021, nga subjektet zgjedhore ne perputhje me ligjin nr.10019, date 29.12.2000 per Kodin Zgjedhor i R.Sh., i ndryshuar, ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per Partite Politike", I ndryshuar, ligjin nr. 10091 date 05.03.2009 "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" dhe Ligjin nr. 25/2018 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe aktet nenligjore te nxjerra per zbatim te tyre.
- Vendimi i KQZ-sënr. 426, date 12.07.2021 -:Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve financiare dhe audituesve ligjore, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perftuara dhe te shpenzuara nga subjektet zgjedhore per fushaten zgjedhore, per zgjedhjet per Kuvendin e Shqiperise date 25.04.2021 .
- Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

#### *Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor*

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar për fushatën zgjedhore, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të subjektit zgjedhor.

Subjekti zgjedhor duhet të verë në dispozicion të Audituesit Ligjor të gjithë dokumentacionin financiar në lidhje me fushatën zgjedhore të vitit 2021, transaksionet bankare 3 muaj para dhe pas dates së zgjedhjeve dhe çdo informacion tjetër shtesë që Audituesi Ligjor do ta gjykojë të nevojshëm për kryerjen e shërbimit të auditimit.

Subjekti zgjedhor duhet të japë Audituesit Ligjor të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat ai është në dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare sic janë regjistrimet, dokumentacioni dhe ceshtje të tjera si dhe të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda subjektit zgjedhor nga të cilët gjykohet e nevojshme për të marrë evidence auditimi.

Si pjesë perberese e procesit të auditimit, Audituesi kërkon nga subjekti zgjedhor të marrë prej tij konfirmime me shkrim lidhur me paraqitjet që do të behen në lidhje me auditimin.

#### *Përgjegjësitë e Audituesit*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

-Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontroleve të brendshme.

-Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

-Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera

-Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave teraportimit financiar për fushatën zgjedhore dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

#### **c. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR**

##### **i. Prezantimi i subjektit zgjedhor**

Ne dokumentacionin e Zyres së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, rezultojnë se Ne dokumentacionin e Zyres së Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, rezultojnë se me urdher Nr.2064 datë 17.05.2002 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar krijimi i Partisë Kristian Demokratike, me iniale "PKD". Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie janë të percaktuara në program dhe në statutin e saj. Partia Kristian Demokratike ka për qëllim konkurimin politik përmes zgjedhjeve të përgjithshme, në respekt të vlerave të lirise, barazise dhe drejtësisë në një garë politike. Ajo synon të promovojë në interes të Shqipërisë dhe shqiptarëve lirinë e mendimit dhe dinjitetin e individit, të drejtat dhe detyrat themelore të tyre, zhvillimin e iniciativës së lire dhe barazisë në shans, tregun e lire dhe konkurrencës si instrument për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit, shtetit e se drejtës, sigurinë e individit dhe të pronës, përgjegjësinë individuale dhe fuqizimin e familjes, drejtësinë shoqërore dhe dialogun social, ruajtjen e natyrës dhe të ambientit, autoritetin e shtetit dhe vetqeverisjes së lire të kolektiviteteve lokale. Adresa e Partisë është :Rr.Deshmoret e Kombit, Pall.32, Shk.1, K 2-te, Ap.5, Tirane.

##### **ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit**

Organet qendrore të PKD-së janë:

- Kuvendi i Partisë;
- Këshilli Kombëtar;
- Kryetari dhe zëvendësit e tij;
- Kryesia e PKD;
- Sekretari i Përgjithshëm.

Burimet e financimit të Partisë janë:

- Te ardhurat nga kuotat e anëtarëve;
  - Te ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike;
  - Ndihmat dhe dhuratat e anëtarëve dhe të perkrasësve të PKD-së
- Cdo e ardhur tjetër që nuk bën në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

**D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ**

- i. Struktura e raportit të auditimit
  - kërkesat formale
  - të ardhurat
  - shpenzimet
- ii. Gjate procesit të auditimit, audituesi ligjor ka kontaktuar me kryetarin e partisë PKD-se, z. Dhimiter Muslla, dhe financierin e saj z.Nik Necaj të cilet kane dhene informacionet e kerkuara per kryerjen e misionit.
- iii. Partia PKD e ka pergatitur dhe dorezuar raportin e financimit të fushatës zgjedhore në përputhje me kërkesat e raportimit.

Formati i Raportimit eshte miratuar me Vendimin nr. 13 , date 06.04.2021 te Komisionit Rregullator

**II. KËRKESAT FORMALE**

**A. PËRMBLEDHJE**

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	27.08.2021
	b) dorëzim fizik	Po	27.08.2021
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	30.07.2021
3/ Llogari bankare veçantë / Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Po	Nuk eshte hapur llogari e posacme bankare per fushaten zgjedhore, eshte perdorur llogaria ekzistuese prane BKT-se e subjektit zgjedhor PKD

	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Po	01.01.2020 - 26.10.2021
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Nik Neca

#### B. ANALIZA

##### a/ Llogaria bankare e vecantë

###### - Llogaria bankare

- o Nuk është hapur llogari bankare e vecante për për fushatën zgjedhore.
- o Nuk ka ndonjë llogari bankare tjetër, që është përdorur për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet.
- o Nuk ka raste të llogarive bankare "të fjetura" që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme
- o Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është raportuar pa përfitim fondesh dhe pa shpenzime pra është i balancuar.

###### - Plotësia e informacionit

- o Evidenca e çeljes së llogarisë bankare.
- o Dokumenti i lëvizjeve bankare (bank statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore është për veprimet bankare të periudhës 01.01.2020 - 26.10.2021).

##### b/ Personi përgjegjës për Financën

###### - Identiteti i personit përgjegjës për financën:

- o Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partisë është z. Nik Neca, i cili e kryen shërbimin në mënyrë vullnetare.
- o Çështje të mospërputhjeve të mundshme – Nuk ka çështje të mospërputhjeve të ndryshme.

###### - Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:

- o Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore është bërë nga kryetari i partisë z. Dhimiter Muslija dhe përgjegjësi për financat z. Nik Neca.
- o Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes:

a) bosh/mungon informacioni	Jo		
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	<b>Të Ardhurat</b>		
		Financime publike	0
		Donacione private	0
		Financim nga burimet e veta të partisë	0
		Huatë/Kreditë	0
	<b>Shpenzimet</b>		
		Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	0
		Materialet promovuese	0
		Media	0
		Sondazhe të Opinionit Publik	0
		Botime	0
		Transporti	0
		Konsulenca	0
		Reklamime në natyre	0
		Administrative	0



III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
<b>1/ Financimi publik</b>			
	Fondi i mare paradhënie	0	0
	Data e tranfertës	-	-
	Kompensimi financiar paszgjedhor	0	0
	Data e transfertës	-	-
	Diferenca e kthyer	0	0
	Data e transfertës	-	-
<b>2/ Donacionet private</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma e donacioneve në para	0	0
	Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
	Përgatitet një listë e donatorëve		NA (nuk ka)
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		Ne bank statement nuk ka lëvizje monetare.
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma)		NA (nuk ka)
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data)		NA (nuk ka)
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		NA (nuk ka)
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		NA (nuk ka)
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		NA (nuk ka)



	Respektimi i kufirit të donacionit		NA (nuk ka)
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	-	-
	Kuotat e anëtarësisë	-	-
	Botimet	-	-
	Shtypshkronja	-	-
	Marrje me qera	-	-
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	-	-
	Kuotat e anëtarësisë	-	-
	Botimet	-	-
	Shtypshkronja	-	-
	Marrje me qera	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(data)	-	-
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0	0
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	-	-
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	-	-
<b>5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave</b>			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Jo	Nepermjet llogarise ekzistuese prane BKT

## **B. ANALIZA**

### **a/ Financimi publik**

- Partia PKD deklaroi se nuk ka perftuar asnje fond publik
- Partia PKD deklaroi se nuk ka bere reklama, publikime per qellime te fushates zgjedhore.

### **b/ Financimi nga burimet jo publike**

- Donatore – nuk ka
- Burimet e palejuara – nuk ka
- Kontributet në natyrë – nuk ka

### **c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike**

- Partia PKD deklaroi se nuk ka financime nga burime te brendshme te saj.
- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
  - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra – nuk ka
  - o Botimet – nuk ka
  - o Shtypshkronjat – nuk ka
  - o Marrja me qera, etj – nuk ka
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
  - o Zyrat Qendrore - 0
  - o Degët lokale - 0
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruara dhe deklarimit bankar (bank statement)**  
Nuk ka te ardhura dhe ne bank statement nuk ka hyrje parash.

### **d/ Huatë/Kreditë – PKD deklaroi se nuk ka marre kredi**

**IV. SHPENZIMET**

**A. PËRMBLEDHJE**

Shuma e përgjithshme e raportuar		0 leke					
Respektimi i kufirit të shpenzimit		Nuk ka shpenzime					
<b>Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë</b>							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dheaktivitetet e fushatës	-						-
Materialet promovuese	-						-
Media/Media Sociale	-						-
Sondazhet	-						-
Botimet/Publikimet	-						-
Transporti	-						-
Konsulenca	-						-
Reklammat në natyre	-						-
Shpenzime zyre elektorale dhe Administrative	-						-

Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	-						-
Materialet promovuese	-						-
Media/Media Sociale	-						-
Sondazhet	-						-
Botimet/ Publikimet	-						-
Transporti	-						-
Konsulenca	-						-
Reklamat në natyre	-						-
Shpenzime zyre elektorale dhe Administrative	-						-
<b>Shpenzimet zgjedhore</b>							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Nuk ka shpenzime

**B. ANALIZA**

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve: - nuk ka pasur shpenzime gjate fushates zgjedhore

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

- Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës :
  - o Pagesa për vendin;
  - o Shpenzimet e zbavitjes;
  - o Shpenzimet e pajisjeve;
  - o Shpenzimet për pijet;
  - o Shpenzimet e dekorit/vizuales;
  - o Shpenzimet e Transportit;
  - o Shpenzimet e Administratës;
- **Materialet promovuese**
- **Media**
- **Sondazhet e opinionit publik**
- **Botimet**
- **Transporti**
- **Konsulenca**
- **Reklammat në ambientet e jashtme**
- **Administrative dhe të përgjithshme**

**V. PËRFUNDIMI**

**A. SINTEZA**

- o Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

- Gjate procesit te auditimit te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara te fushates u konstatuan keto gjetje:
  - Subjekti zgjedhor PKD nuk ka hapur nje llogari te posacme bankare per fushten zgjedhore referuar nenit 90, pika 2 e Kodit Zgjedhor.
  - o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit-  
Nuk ka patur parregullsi gjate procesit te auditimit

- o Krahasimi me raportin e monitorimit  
Ne raportet perfundimtare te monitorimit nuk ka pasur informacion specifik per PKD.

## B. PËRFUNDIMI

### Opinionit pa rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore per Kuvendin e Shqperise te dates 25.04.2021, të subjektit zgjedhor Partia Kristian Demokrate, PKD, të cilat përfshijnë pasqyrat sipas formatit te standardizuar te raportimit financiar per fushaten zgjedhore me Vendimin nr.13, date 06.04.2021 te Komisionit Rregullator.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore, me perjashtim te ceshtjes se pershkruar te permbledhja e gjetjeve dhe pefundimeve; paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, financimet dhe shpenzimet, në përputhje me ligjin nr.10019, date 29.12.2000 per Kodin Zgjedhor te R.Sh., i ndryshuar, ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per Partite Politike", I ndryshuar, ligjin nr. 10091 date 05.03.2009 "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" dhe Ligjin nr. 25/2018 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

### Baza për Opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë pershkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare në Shqiperi, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Ludmilla Paluka  
Auditues Ligjor

Tirane me 26.10.2021

